



Das Lehrstellenprojekt 16+ der Schweizerischen Konferenz der Gleichstellungsbeauftragten motiviert Mädchen zu einer offenen Berufswahl und zeigt Knaben erweiterte Lebensperspektiven.

Ein Projekt im Rahmen des Lehrstellenbeschlusses 2 des Bundesamtes für Berufsbildung und Technologie BBT.

## **NGA SHKOLLA TE PROFESIONI**

Një informatë për prindër (albanisch)

Të dashur prindër

Keni vajzën apo djalin tuaj në klasën e 7, 8, 9 ose të 10-të. Djali apo vajza e juaj duhet të vendosë për profesionin apo shkollimin e mëtutjeshëm.

Një spektër i gjërë i profesioneve dhe një rrugëtim i paramenduar dhe i planifikuar mirë mundëson një hap të suksesshëm në botën e profesioneve. Zgjedhja e profesionit është shumë e rëndësishme posaçërisht për vajzat, në mënyrë që ato ta gjejnë profesionin që orienton të ardhmen e tyre.

Shkolla dhe këshillimorja për profesione ndihmojnë të rinjtë në zgjedhjen e profesionit. Mirëpo, përgjegjësia dhe puna kryesore u mbetet vetë atyre. Bija apo biri juaj duhet pra që vetë të bëjë shumë, gjërë sa të gjejë një vendmësim (Lehrstelle).

Për shumë prej tyre kjo është shumë e veshtirë. Shumica nuk kanë bërë kurrë një gjë të tillë. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme ndihma e prindërve.

### **SI NDIHMON SHKOLLA?**

Shkolla përgaditë nxënësit në klasën e 8 dhe 9 për zgjedhjen e profesionit apo shkollimin e mëtutjeshëm. Pyesni mësuesin / mësuesin se cilat janë këto parapregaditje.

### **SI NDIHMON KËSHILLIMORJA PËR PROFESIONE?**

Qendra Informative për Profesione (BIZ) ofron informacione për fusha të ndryshme të profesioneve dhe të arsimimit. Një këshillë personale nxënësve u ofrohet falas në këshillimoren për profesione.

# E ÇKA DUHET TË BËJNË VETË TË RINJTË

## KËRKO PËRKRAHJE DHE PRANO NDIHMA

Linda dëshiron të bëhet Polimekanike. „O Zot i madh“ thoshte babai, „Femrat nga kultura jonë nuk mësojnë profesione rreshkujsh“. Edhe vëllai i sajë, vetë në mësim të profesionit të Polimekanikës në vitin e IV -të, mendonte: „Kjo s'bënë. Ti do të jesh tërë ditën vetëm me meshkuj. Kjo s'do të të pëlqej as ty. Ti nuk do të kesh askend me kë do të mund të bisedosh. Që të të akceptojnë të tjerët, ti duhet të bëshë shumë më tepër se ata të gjithë. E di kështu sepse një vajzë ka mësuar tani tek ne në Automatikë“.

Përkundër gjitha kundërshtimeve Linda konkuron në një vend të tillë të provoj profesionin në fjalë. - Në një të dytë keni të drejtë,- u tha Linda babait dhe vëllait pas një jave të mësimi. „Unë jam e vetmja femër në punishtë, por kjo s'ka rëndësi. Më pëlqen puna me makina puna me metale. Unë dua të bëhem polimekanike. Nëse ju më përkrahni, do t'ja arrij.“

## TË NJIHEN ME PROFESIONET

Çfarë lloje profesione ka? Çfarë bëhet aty? Çka duhet ditur mirë?

- ✓ Të shkojë në BIZ, të nformohet, t'i lexoj përshkrimet e profesioneve ti shiqoj video kasetat
- ✓ Të bisedoj me personat e autorizuar nga këshillimorja për profesione
- ✓ Të vizitoj ekspozitat dhe orientimet tjera të profesioneve
- ✓ Të bëjë mësim provues

## TË NJOHË VETËVETEN DHE TË ZGJEDHË SHKOLLËN APO PROFESIONIN

Çfarë bëjë mirë në shkollë, çka kam mësuar në kohën e lirë apo në familje? P.sh. njohja e gjuhëve të huaja, reparimi i aparateve shtëpiake, ruajtja e fëmijve, blerja. Cili profesion, cili shkollim më përshtatet më se miri?

- ✓ Të bisedoj me prindër mbi profesionet dhe t'i pyes ata: Cila punë më përgjigjet më së miri?
- ✓ Të bisedoj me mësuesin/ mësuesen: A e flas mirë gjermanishten, frengjishten dhe a e njohë matematiken? Cilat janë të metat e mia? Si mund të përgatitem në shkollë për një arsimim të mëtutjeshëm pas klasës së 9 dhe 10?
- ✓ Të caktoj takim në këshillimore (BIZ) dhe të pyes: A jam mjaft i përgatitur për profesionin të cilin dëshiroj t'a mësoj? Çfarë duhet të bëjë nëse kam të meta?
- ✓ Të zgjedh një profesion të përshtatshëm apo shkollim të mëtutjeshëm me 1 apo 2 alternativa (mundësi).

## MËSOJ DUKE PYETUR

Gjoni jeton kohë të shkurtër në Zvicër dhe ndjek mësimet në shkollën e mesme të shkallës mesme (SEC C). Kjo i përkufizon jashtë mase zgjedhjen e profesionit. Profesionit që ai ëndërronte është laborant i kimisë. Me gjithë hendikepin në shkollën e shkollimit ai konkuron në një vend për rresim. Por ndërmarrja i ofron atij mundësin të filloj si laborant por në paramësim (Anlehre). Prindërit e tij mendonin se ai duhej t'a bëjë këtë shkollë të shkollimit me çka do të bëjë hapin e parë në botën e punës. Mirëpo „Unë mundem më shumë. E di këtu“, ankohej ai. Pas diskutimeve të gjatë në familje, Gjoni thërret në ndërmarrje dhe pyet, se çka i mungon atij për një vendmësim si laborant i kimisë. Shumë të meta në matematikë dhe gjermanisht, ishte përgjegjja. Prindërit i paguan atij kurse në një shkollë private. E ai mëson, mëson. Pas disa muajsh arriti ti bind mësuesit e tij me çka iu mundësua që të përsëris testin pranues. Ai u tregua aq i mirë sa që kontrata e tij u shëndrrua në një kontratë të mësimit të profesionit të laborantit të kimisë në vend të asaj të mëparshmes..

## KËRKIMI I NJË VENDMËSIMI

(sipas rregullave nga vjeshta e klases s 9-ta)

- ✓ Ku ofrohen vende për mësim në të cilët mund të mësoj profesionin që kam zgjedhur?
- ✓ Ku ka shkolla për arsimim të mëtutjeshëm?
- ✓ Çka duhet bërë, që të gjejë një vend për mësim?

## NË TENTIMIN E DYTË

Në të vërtetë, Hyrija e dinte saktësisht se çka dëshironte të mëson: Teknike e ndërtimtarisë. Babai i sajë ia gjenë një vend për mësim të profesionit tek kolegu i një shoku. “Ajo ka talent“, - mendonte arhitekti pas javës së parë të mësimit provues. Mirpo qendrimi i saj!? Ajo gjithmonë priste që ne t'i sqaronim diçka. Kurrë nuk pyeste. Babai ishte tepër i zhgënjyer.

Kështu mbeti Hyrija për një vit mësimi në një familje duke u përkujdesur për katër fëmijë. „Çdo gjë është në rregull,“ - thoshte ajo. Unë i dua fëmijët. Mirëpo e kam vërejtur se nuk rruad tërë jetën të punoj në mirëmbajtjen e shtëpisë. E karn të qartë që duhet të përpiqem më shumë, nëse dëshiroj të mësoj profesionin që e ëndërroj.“ Ajo mori kurajo dhe e pyeti arhitektin se mos ndoshta do të mund edhe njëher të bëjë një provë njëjavshe. Arhitekti pranoi por sqaroi se këtë vit ai nuk kishte vend për mësim. Mirëpo, kësaj radhe Hyrija i bënte gjërat aq mirë, sa që jo vetëm babai por edhe arhitekti i ndihmoi në kërkimin e vendit për mësim. Dhe ia arriti. Tani Hyrija mëson për teknike të ndërtimtarisë.

**ZGJEDJA E NJË PROFESIONI APO TË NJË SHKOLLIMI TË MËTUTJESHËM KËRKON KOHË. DJEMT DHE VAJZAT E JUAJA JANË TË VARUR NGA NDIHMA E JUAJ.**

## **JU MUND TË PËRKRAHNI VAJZËN, DJALIN TUAJ**

Si prindër keni mundësi të ndryshme të përkrahni aktivisht birin apo bijën tuaj në zgjedhjen e profesionit dhe kërkimin e vendmësimit.

### **VIZITONI TAKIMET ME PRINDËR TË ORGANIZUARA NGA SHKOLLA**

Në takimet e prindërve ju mund të merrni informata të rëndësishme që i paraprijnë mënyrës së zgjedhjes së profesionit dhe kërkimit të vendit për mësim. Do të keni një vështrim në sistemin Zvicëran të zgjedhjes së profesioneve, dhe mësoni se si përkrahet biri apo bija juaj nga shkolla në zgjedhjen e profesionit. Poashtu mund të këmbeni përvoja me prindër tjerë që kanë fëmijë poashtu në moshën e zgjedhjes së profesionit.

### **SHFRYTËZONI LIDHJET E JUAJA**

Shrytëzoni kontaktet që i keni në vendin e punës, në klube, në shoqata apo në rrethin tuaj dhe tregoni gjithëkund se biri apo bija juaj kërkon një vend mësim. Ndoshta ndokush njih ndonjë ndërmarrje që ofron një vendmësim të tillë, apo ju vihet në dispozicion si person kontaktuar.

### **TREGONI KURAJO**

Gjetja e një vendi për mësim në një situatë të këtillë ekonomike nuk është lehtë. Biri apo bija juaj duhet që në këtë kohë të marrë shumë iniciativa dhe të ketë shumë durim. Merrni pjesë në përvojat që ai apo ajo i bënë. Tregoni mirëkuptim kur zhgënjimi është i madh pas çdo refuzimi. Jepni kurajo që përsëri të provoj në ndonjë vend tjetër.

### **ÇKA PAS REFUZIMEVE**

Nese bija apo biri i juaj merrë refuzime të njëpasnjëshme në kokurimet e saja, ja vlenë gjithnjë edhe njëherë të analizohet rrenjësishtë përzgjedhja e profesionit. Ndoshta për afër profesionit të dëshiruar ka edhe profesione tjera, që janë më pak të njohura, por poashtu interesante dhe të përshtatshme për bijën apo birin tuaj. Merrni kontakt me këshillimorin për profesione. Këshilltari / këshilltarja për profesione ju përkrahin ju, bijën apo birin tuaj gjerë në gjetjen e një zgjedhje të mirë.

### **ZGJIDHJET E NDËRMJETME**

Ndoshta bija apo biri juaj përkundër kërkesave intezive për momentin nuk gjenë vend për mësim, apo ndoshta ka mangësi në shkollë të cilat duhet t'i plotësoj, ja vlen që pas shkolimit të obliguar ta gjendet një zgjidhje kalimtare. Këto zgjidhje kalimtare sipas rregullave zgjasin një vit dhe i aftësojnë për një ngritje në botën e profesioneve. Informohuni në këshillimoren për profesione mbi ofertat e ndryshme dhe kostot e tyre. Kujdesuni sepse paraqitja e juaj për një zgjidhje kalimtare shpeshë është e nevojshme të bëhet që në shkurt. Në qoftë se bija apo biri juaj ndërkohë gjenë një vend për mësim mund që përsëri të lajmrohen.